



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 8492 prot.

Roskovec, më 29.10.2024

VENDIM

NR 66 .DATE 28.10.2024

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “RRITJA E
SIGURISË SË DIGËS DHE PËRMIRËSIMI I AFTËSISË UJËMBLEDHËSE TË
REZERVUARIT TË KURJANIT”**

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2 shkronja "b" të Ligjit 139/2015 datë 19.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; të nenit 7, nenit 8 shkronja "ç", nenit 9 pika 1, nenit 10 pika 1 shkronja "c", nenit 11, nenit 17 dhe nenit 19 të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 138, datë 23.03.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 559, datë 11.09.2024 "Për një ndryshim në vendimin nr.226, datë 09.04.2024 të Këshillit të Ministrave "Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit për financimin e projekteve të bashkive nga programi "Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes", kthim përgjigje të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 6321/1, datë 13.12.2023, shkresës nr. 5495/1 prot, datë 21.10.2024 të ASHK-së Fier, si edhe shkresës me nr. 382/1, datë 21.10.2024 i Agjencisë së Ekstensionit bujqësorë Lushnje, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Shpronësimin e pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga zbatimi i projektit: *"Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësisë ujëmbledhëse të Rezervuarit të Kurjanit"* sipas listës bashkëngjitur.
- 2- Miratimin e vlerës së Shpronësimit të pasurive të sipërcituara me vlerë paraprake si më poshtë:

- **Vlera e tokës arë: 1 883 000 lekë**
- **Vlera e kulturës bujqësore: 598 500 lekë**
- **Totali: 2 481 500 lekë**

- 3- Fondi për këtë qëllim do të përballohet nga buxheti i bashkisë.
- 4- Ngarkohet Komisioni i Shpronësimeve me zbatimin e këtij vendimi.
- 5- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Afrim Plaka

